



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

Nr. 169 Prot.

Datë 19/12 / 2023

URDHËR

NR. 59, DATË 19/12 / 2023

PËR

**MASAT ADMINISTRATIVE/PROCEDURIALE PËR RRITJEN E HETIMEVE
TË FILLUARA KRYESISHT PËRMES INFORMACIONEVE MEDIATIKE,
INTERNETIT DHE BURIMEVE TË TJERA TË HAPURA, ETJ.**

Në mbështetje të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurës Penale, neneve 41, 42, 52, etj, të ligjit nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores Standarte per Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale, shtimin e rasteve të hetimeve të veprave penale të filluara kryesisht, si dhe mirëfunksionimin e veprimtarisë së prokurorisë, etj;

URDHËROJ:

1. Të caktohen/ngarkohen oficerët e policisë gjyqësore Z. Dritan Ibro dhe Z. Dorjan Hoxha, që krahas detyrave funksionale, të monitorojnë/verifikojnë rregullisht nën mbikqyrjen e prokurorit të shtypit informacionet dhe të dhënat që publikohen/vijnë nga media, interneti apo burime të tjera të hapura dhe në rast idicie/dyshime për ekzistencën e ndonjë vepre penale që ndiqet kryesisht, të kryejnë verifikimet përkatëse dhe pas konsultimit/vlerësimit të informacionit dhe materialeve të verifikimeve paraprake me prokurorin e shtypit apo drejtuesit e seksionit, sipas kompetencës lëndore, të referojnë materialin/veprën penale në Prokurori, së bashku me verifikimet paraprake të kryera, sipas parashikimeve të ligjit procedural penal.
2. Oficerët e policisë gjyqësore të tregojnë vëmendje të veçantë për ndjekjen, vlerësimin dhe verifikimin e informacioneve që vijnë nga media, interneti apo burime të tjera të hapura, në datat e tyre të gadishmërisë, por jo vetëm, dhe në rast konstatimi të të dhënave që përmbajnë idicie apo dyshime mbi ekzistencën e elementë të ndonjë vepre penale që

ndiqet kryesisht, të njoftojnë menjëherë prokurorin e gatshëm dhe pas konsultimit/vlerësimit paraprak me prokurorin, të vijojnë veprimet dhe referojnë materialin/veprën penale në Prokurori sipas parashikimeve të ligjit procedural penal.

3. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij urdhëri ngarkohen prokurori i shtypit dhe drejtuesit e seksioneve në prokurori.
4. Me këtë urdhër të njihen drejtuesit e seksioneve, prokurori i shtypit, oficeret e policisë gjyqësore Dritan Ibro dhe Dorian Hoxha, si dhe të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve.
5. Të administrohet një kopje e këtij urdhëri në aktet e fashikullit të drejtuesit të Prokurorisë.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet sipas rregullave në faqen e prokurorisë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Elion MUSTAJ

